



**KONTROLLI I LARTE I SHETIT**  
*Departamenti i Auditimit të Administrimit të Aseteve,*  
*Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit*

Nr. 377/5Prot.

Tiranë, më 30.06.2016

**V E N D I M**

**Nr.79, Datë 30.06.2016**

**PËR**  
**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË**  
**RAJONALE TË ALUIZNI-t, BERAT “MBI VLERËSIMIN E AKTIVITETIT**  
**EKONOMIKO FINANCIAR, PROÇEDURAT E SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT TË**  
**KËRKESAVE PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE INFORMALE”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Sigurimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Berat, për periudhën nga data 01.01.2014 deri me datë 31.12.2015 .

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

## **A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga Drejtoria e ALUIZNI-t Berat konstatohet se në **12 raste** lejet e legalizimit nuk janë lëshuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 28, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“ (*Trajtuar më hollësisht në faqen 33-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat, të marrë të gjitha masat që të hartojë programe pune të mirë studiuar, si dhe përcaktimin e ngarkesës së plotë të stafit teknik, për të bërë të mundur që lejet e legalizimit të lëshohen brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në ligj.

*Deri më datë 30.09.2016*

**2. Gjetje nga auditimi:** Në treguesit e Projekt buxhetit dhe buxhetit të viteve 2013, 2014 dhe 2015, u konstatua se planifikimi i nevojave të Drejtorisë për shpenzimet për paga, operative dhe investime, nuk janë bërë në përputhje me metodologjinë e hartimit të P/buxhetit afat mesëm dhe buxhetit vjetor. Për rrjedhojë nuk janë ngritur grupet e punës sipas strukturave organizative, për të hartuar nevojat për transferata të pakushtëzuara dhe të ardhurat e realizuara nga vetë subjekti, por është mjaftuar me dërgimin e tyre në Drejtorinë Qendrore të ALUIZNI-t. Këto veprime të pa studiuar kanë diktuar nevojën e ndryshimeve të herë pas herëshme të treguesve të buxhetit, duke e bërë atë të pabesueshëm e joefiçient, me pasojë vonesa në pagesat e detyrimeve ndaj të tretëve (*Trajtuar më hollësisht në faqen 100-112, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Berat, të marrë masa për planifikimin e projekt buxheteve dhe buxheteve në vitin 2016 e në vazhdim, në uniformitet me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t, të zbatojë me rigorozitet metodologjinë e planifikimit buxhetor, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe udhëzimeve për zbatimin e buxhetit. Për këtë, të krijojë grupet përkatëse të planifikimit, duke harmonizuar drejt nevojat për fonde me kohën e përdorimit të tyre. Veçanërisht të përcaktohen nevojat reale për treguesit e shpenzimeve që planifikohen me përparësi dhe në mënyrë të detyrueshme, si: energjia elektrike, shpenzime uji, prokurime, etj, për të cilat, vonesat pasojnë gjoha e penaltete. Gjithashtu, të bëhet përputhja e planifikimit dhe realizimit për shpenzimet që mbulohen nga të ardhurat e vetë subjektit.

*Deri më datë 30.09.2016*

**3. Gjetje nga auditimi.** Nga verifikimi i dokumentacionit të prokurimeve me vlera të vogla konstatohet se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është njëkohësisht edhe Komisioni i Marrjes në dorëzim të materialeve të blera, veprim në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2012, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, paragrafi “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, pika 42. Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues, pika 43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale (*Trajtuar më hollësisht në faqen 100-112, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Berat të marrë masat e nevojshme, për të ngritur në fillim të vitit ushtrimor Komisionin e prokurimeve me vlera të vogla dhe Komisionin e marrjes në dorëzim të mallrave, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore në prokurimet me vlera të vogla.

*Deri më datë 30.09.2016*

**4. Gjetje nga auditimi.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit “Për procedurat e hollësishme të rimbursimit të personave që përfitojnë nga e drejta e pagesës me bono privatizimi për legalizimin e objekteve informale” rezulton se në tabelat përmbledhëse për subjektet që përfitojnë, nga ALUIZNI Berat nuk janë bashkëlidhur njoftimi zyrtar dhe formulari përkatës, ku është përcaktuar vlera monetare për të cilën përfitojnë rimbursim. Në zbatim të ligjit, qytetarët duhet të paraqesin kërkesën për rimbursim brenda afatit 3 muajor nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 10219, datë 04.02.2010), të përcaktuar në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë Punëve Publike dhe Transporteve nr. 2350, datë 20.05.2013 dhe Ministrisë Financave nr. 8113/1, datë 23.05.2013 (*Trajtuar më hollësisht në faqen 100-112, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t të hartojë dokumentacion përmbledhës të plotë dhe të saktë për pagesat e rimbursimit të personave që përfitojnë nga e drejta e pagesës me bono privatizimi për legalizimin e objekteve informale, duke i bashkëlidhur në çdo dosje kërkesën dhe dokumentacionin e arkëtimeve të detyrimeve nga qytetarët, të cilët pretendojnë se janë përfitues të rimbursimit.

*Deri më datë 30.09.2016*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se për **306 objekte informale** që nuk plotësojnë kriteret ligjore për legalizim nuk janë zbatuar procedurat për s`kualifikimin e tyre, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, pikën 5 të nenit 2 dhe nenin 39-*Përfundimtar nga Legalizimi*, Kapitulli IV i VKM nr. 438, datë 28.06.2006, Urdhrit nr. 291, datë 01.09.2008, i ndryshuar me Urdhrit nr. 846, datë 11.10.2012, si dhe pikat 2 dhe 3 të neni 42, të VKM nr. 40 datë 11.01.2012 (*Trajtuar më hollësisht në faqen 33-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat të marrë masa, për të gjitha objektet informale që nuk plotësojnë kriteret për legalizim, të ndiqen procedurat ligjore për s`kualifikimin e tyre si dhe të informohen në kohë aplikuesit e legalizimeve dhe institucionet bashkëpunuese.

*Deri më datë 30.09.2016*

**6. Gjetje nga auditimi :** Nuk është bërë inventarizimi i dosjeve mbi dokumentacionin përkatës të objekteve informale, nuk janë mbajtur rregullisht në protokoll hyrjet e daljet nga arkiva dhe nuk janë protokolluar urdhrat e punës të nxjerrë nga titullari i institucionit. Për vitet 2014 dhe 2015 nuk ka dokumentacion mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të detyrës, veprime në kundërshtim me nenin 22, pika 2, si dhe nenin 24, të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “ Mbi Arkivat në RSH” si dhe me Rregulloren e Brendshme me nr. 117, datë 14.07.2015 " Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale ", neni 26/5, pika 4, pika 5 dhe pika 13 (*Trajtuar më hollësisht në faqen 33-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat, nëpërmjet strukturave organike të saj, të marrë masa për inventarizimin e dosjeve të legalizimit dhe të arkivojë ato, duke zbatuar me rigorozitet kërkesat e ligjit për arkivat.

*Deri më datë 30.09.2016*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatuan **26 raste** mbivendosje të pronës së legalizuar me prona të tjera kryesisht "rrugë" dhe në pronë “shtet”, veprime në kundërshtim me ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integritimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, VKM nr. 438, datë 28.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" pika 2/c, si dhe urdhrin

të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 291, datë 01.09.2008, pika 2.4 dhe rregulloren e brendshme, Kapitulli VI.

-Legalizimet janë kryer bazuar në dokumentacionin e konfirmuar për statusin juridik të pronës lëshuar nga ZVRPP, për pronën “Shtet”, “Truall + Ndërtesë” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 61-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat të marrë masa për saktësimin e pronës të objekteve të legalizuara dhe plotësimin me dokumentacionin e nevojshëm ligjor për regjistrimin në ZVRPP Berat, Kuçove, Ura Vajguore, Kozarë dhe Skrapar dhe në rast mos plotësimi të kërkesave ligjore të zbatohen procedurat për s`kualifikimin e tyre.

*Deri më datë 30.08.2016*

**8. Gjetje nga auditimi:** Në Drejtorinë e ALUIZNI-t Berat nuk janë plotësuar të gjitha të dhënat në database-n elektronik, në pasqyrat e vet deklarimeve sipas ekstremiteteve të duhura, bazuar në Urdhrin nr. 291, datë 01.09.2008 dhe nr. 846, datë 11.10.2012 të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 437 datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e procedurave për mbledhjen, përpunimin e administrimin e të dhënave për ndërtimet pa leje për ngritjen e bazës të dhënave” dhe Urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t nr. 7 datë 08.11.2006, pika (e) dhe nr. 767 datë 10.09.2014 (*Trajtuar më hollësisht në faqen 100-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat të marrë masa për plotësimin dhe hedhjen e të dhënave në database-n elektronik sipas procedurave ligjore dhe udhëzimeve përkatëse të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

*Deri më datë 30.09.2016*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në **5 dosje legalizimi**, nisur nga dokumentacioni i administruar në dosje, si genplani dhe harta digjitale, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej buzës së Lumit Osum prej 90-170 metra. Në këto raste nuk duhet të jepej leja e legalizimit ose procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit, gjë që nuk ka ndodhur pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacion i justifikues për këtë qëllim.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 111/2012, datë 15.12.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, neni 4/ pika 8, neni 5 dhe neni 84 “Veprimtaritë në brigje”, si vijon:

- Në 1 dosje largësia nga bregu është 5-100 m, në kundërshtim me nenin 84/a.
- Në 4 dosje largësia nga brigjet është 100-200 m, në kundërshtim me nenin 84/b.

-VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, Kapitulli II, pika 2, germa “gj” dhe Kapitulli III, pika 4, germa “dh” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 40-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat, të marrë masa dhe të zbatojë legjislacionin në fuqi lidhur me legalizimin e objekteve informale, duke patur parasysh gjithmonë largësinë e objekteve nga brigjet e lumenjve, përrrenjve, kanaleve, liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, etj., duke mos kryer asnjë legalizim të objekteve informale në largësi deri në 100 m nga brigjet e Lumit “Osum” dhe në rast se distancat janë në kufijtë 100-200 m, të merret konfirmimi nga Këshilli Kombëtar i Ujit.

*Vazhdimisht*

**10. Gjetje nga auditimi:** Në 3 dosje legalizimi, u konstatua se sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP Berat, parcelat ndërtimore të zëna ndodhen në zonat e regjistruara në zërin kadastral “Kullotë”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në “Truall”, në kundërshtim, me nenet 10 dhe 17/3, 6, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar (*trajtuar në faqet 46 deri 48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat, të marrë masa dhe të zbatojë legjislacionin në fuqi lidhur me legalizimin e objekteve informale dhe të mos lëshojë leje legalizimi në sipërfaqet e parcelave ndërtimore të llojeve “Kullotë” dhe “Pyll”, pa miratimin e Ministrisë së Mjedisit apo Vendim të Këshillit të Ministrave.

*Vazhdimisht*

**11. Gjetje nga auditimi:** Në 17 dosje legalizimi, legalizimet janë kryer bazuar në dokumentacionin e lëshuar nga ZVRPP Berat, ku statusi juridik i pronës paraqitet “E paregjistruar”. Nga auditimi konstatohet se sipas Hartës Treguese të Regjistrimit (HTR), bashkëlidhur shkresave të dërguara nga ZVRPP-ja, janë të përcaktuara pasuri “Ndërtesë”, pronë “Shtet”, të cilat janë adaptuar. Kjo duket nga shenjat konvencionale për të qenë të tilla sipas Rregullores së Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar, kur ndërtimi rezulton “i ligjshëm”. Këto ndërtesa nuk duhej të ishin legalizuar për arsye se ndërtimi është në pronë shtet (*trajtuar në faqet 48 deri 55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat, të marrë masa dhe të zbatojë legjislacionin në fuqi lidhur me legalizimin e objekteve informale, të riverifikojë dhe sqarojë në bashkëpunim me ZVRPP-në për 17 rastet ku sipas shenjave konvencionale kemi të bëjmë me pasurinë “Ndërtesë”, (pavarësisht nëse zona ka hyrë apo jo në sistem) dhe më pas të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit dhe të kryejë kontabilizimin dhe kërkojë arkëtimin e detyrimeve prej subjekteve informale.

*Deri më datë 31.12.2016*

**12. Gjetje nga auditimi:** Në 20 dosje legalizimi, në parcelat ndërtimore pronë “Shtet”, konstatohet se sipas dokumentacionit të pronësisë, dërguar me shkresat e ZVRPP- së, Qarku Berat, statusi juridik për pasuritë është pronë “E paregjistruar”, nuk ka të dhëna të tjera dhe mungon Harta Treguese e Regjistrimit (HTR), në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar (*trajtuar në faqet 55 deri 84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat, të marrë masa dhe të zbatojë legjislacionin në fuqi lidhur me legalizimin e objekteve informale, duke kërkuar dhe pranuar dokumentacionin nga ZRPP-të e Qarkut, me shënime të qarta mbi pronësinë, “Shtet” apo “Privat” dhe në çdo rast të jetë bashkëlidhur HTR-ja përkatëse.

*Vazhdimisht*

**13. Gjetje nga auditimi:** Në 87 dosje legalizimi, u konstatua mungesë dokumentacioni vërtetues dhe justifikues të procesit të legalizimit të objekteve informale, si më poshtë:

-Në 84 dosje legalizimi, proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat e objektit nga pasuritë kufitare me shifra dhe fjalë, jo sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, date 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t (*trajtuar në faqet 55 deri 84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Në 26 dosje legalizimi, proces-verbali i verifikimit në terren është mbajtur nga 1 person, jo sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, date 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të

Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t (*trajtuar në faqet 55 deri 84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Në 38 dosje legalizimi, konstatohet mungesë e ortofotove digjitale, në mospajtim me shkronjën “b”, pika 3, kapitulli I, e VKM nr. 589, datë 10.09.2014 “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale” (*trajtuar në faqet 55 deri 84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Në 4 dosje legalizimi, konstatohet se nuk ishin plotësuar dhe nënshkruar 2 deklaratat personale, në kundërshtim me nenin 27, pika “dh”, të ligjit nr. 9282, datë 03.04.2006, i ndryshuar:

- për marrjen e përgjegjësisë lidhur me zbatimin e planit rregullues/studimit urbanistik pjesor, përfshirë këtu: respektimin e hapësirave publike, gjelbërimin, tipin e rrethimit, ngjyrat, ndriçimin, parkimin, etj.

-për marrjen e përgjegjësisë personale të mbartjes së kostos së dëmtimeve që vijnë si pasojë e cilësisë së punimeve të kryera në objekt dhe shkaqeve natyrore, kur nuk janë respektuar kushtet teknike (*trajtuar në faqet 55 deri 84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat, të marrë masa dhe të zbatojë legjislacionin në fuqi lidhur me legalizimin e objekteve informale, duke plotësuar proces-verbalin e verifikimit në terren me distancat e objektit nga pasuritë kufitare me shifra dhe fjalë, duke marrë pjesë në procesin e verifikimit në terren 2 ose më shumë specialistë, duke plotësuar për çdo rast dosjet me ortofotot digjitale dhe me 2 deklaratat personale, të lëshuara dhe nënshkruara nga pronarët e ndërtimeve pa leje.

*Vazhdimisht*

**14. Gjetje nga auditimi: Në 48 dosje legalizimi,** sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë, ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, Ullishte, Pemishte”, zona informale këto të pa miratuara nga KRRTRSH/KKT, pra legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, për të cilat nuk kanë gjetur zbatim nenet 10, 11 dhe 14 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të Këshillave të Qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Truall” (*trajtuar në faqet 84 deri 94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat, të marrë masa dhe të zbatojë legjislacionin në fuqi, duke kryer legalizimin në zonat “Territore të tjera”: Arë, Ullishte, Pemishte, bazuar vetëm në konfirmimet nga Këshilli i Qarkut Berat, Drejtoria Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit.

*Vazhdimisht*

**15. Gjetje nga auditimi:** Në Drejtorinë e ALUIZNI-t Berat u verifikua zbatimi i detyrave të lëna nga auditimi i mëparshëm, nga ku u konstatua se janë rekomanduar masa shpërblim dëmi në vlerën **17,958,848 lekë** dhe rezulton se nuk janë ndjekur plotësisht procedurat ligjore deri në arkëtimin e detyrimeve (*Trajtuar më hollësisht në faqen 18-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**15.Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Berat të marrë masat organizative për ndjekjen në rrugë ligjore deri në procese gjyqësore të arkëtimit të shpërblimit të dëmit në vlerën 17,958,848 lekë.

*Deri më datë 30.11.2016*

**16. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Berat në zbatimin e detyrave të lëna nga auditimi i mëparshëm për arkëtim shpërblim dëmi, nuk ka ndjekur të gjitha procedurat administrative për korrigjimin e kontratave të shitjes së truallit personave të ndërtimeve informale për **28 praktika** me sipërfaqe 4712.72 m<sup>2</sup>, duke arkëtuar më pak vlerën **15,809,883 lekë**, nga e cila: pagesë me bono në shumën 7,345,884 lekë dhe pagesë në lekë në shumën 8,463,999 lekë, evidentuar si diferencë e pagesës së sipërfaqes së parcelës ndërtimore (*Trajtuar më hollësisht në faqen 18-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**16. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-it Berat të marrë masat organizative për ndjekjen në rrugë ligjore deri në procese gjyqësore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit në vlerën **15,809,883 lekë**.

*Deri më datë 30.09.2016*

**17. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Berat në zbatim të detyrës së lënë nga auditimi i mëparshëm nuk ka ndjekur procedurat ligjore për **82 (tetëdhjetëdy)** praktika legalizimi të ndërtimeve informale, të cilat nuk janë në përputhje me ligjin për integritetin e Monumenteve të Kulturës të zonave arkeologjike dhe nuk janë në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Berat, në zonën e shërbimit të Ujësjellës-Kanalizimeve SH.A, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, si dhe të neneve 31, 32 e 33, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, VKM nr. 6, datë 07.01.2005 “Për miratimin e zonave arkeologjike, brenda qendrave të banuara në Shkodër, Lezhë, Krullë, Durrës, Elbasan, Berat, Vlorë dhe Sarandë”, Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Berat, miratuar me Vendim të KKT-së nr. 7, datë 20.12.2012 dhe Rregulloren në zbatim të tij, VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 (*Trajtuar më hollësisht në faqen 16-17, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**17. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Berat të marrë masat e nevojshme dhe të ndiqen procedurat ligjore për **82 (tetëdhjetëdy)** praktika legalizimi të ndërtimeve informale, të cilat nuk janë në përputhje me ligjin për integritetin e Monumenteve të Kulturës të zonave arkeologjike dhe nuk janë në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Berat.

*Deri më datë 30.09.2016*

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 për “Legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, nga ana e titullarit të njësisë publike (*Nëpunësit autorizues*), të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohen në rrugë ligjore (*Padi Gjyqësore*), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në **25 raste në vlerën 1,248,318 lekë**.

Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin, të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël dhe kërkojë arkëtimin e vlerave deri në përfundim të detyrimeve *si më poshtë*:

**1. Gjetje nga auditimi:** Në **2 dosje legalizimi** nuk gjenden dokumentet për likuidimin e taksës së infrastrukturës, në kundërshtim me pikën “ç”, të nenit 27, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe dokumentet e pagesës për tarifën e shërbimit, në kundërshtim me nenin 24, pika “ë” të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dokumente të cilët nuk ishin inventarizuar apo arkivuar në dosje dhe në protokollin e institucionit, mosveprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat në Republikën e Shqipërisë”, ku nga mos llogaritja dhe mos arkëtimi i taksës së infrastrukturës, konstatohet **një dëm ekonomik prej 56,540 lekë** (trajtuar në faqet 94 deri 99 Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-Berat, në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore të Qarkut Berat, të marrin masa duke ndjekur rrugët ligjore për llogaritjen, saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së taksës së infrastrukturës, si dhe dokumentacionin për tarifën e shërbimit, në **2 raste me vlerë 56,540 lekë**, prej të cilave dosja 2864, subjekti informal “F. M” 48,540 lekë dhe dosja 454 “A.Sh” 8,000 lekë.

*Deri më datë 30.10.2016*

**2. Gjetje nga auditimi:** Në **7 dosje legalizimi**, konkretisht në dosjet nr. 297, 42, 359, 83, 1215/5, 879 dhe 7, për objekte me funksion social-ekonomik, pagesa e vlerës së parcelës ndërtimore është kryer duke aplikuar favorizimet nëpërmjet çmimit favorizues të shitjes së parcelës, me justifikime të ndryshme të kundërligjshme, në një kohë që VKM nr. 488, datë 22.07.2014, bën fjalë për lehtësitë e personave që legalizojnë objekte me funksione banimi dhe të përziera. Këtu përjashtohen objektet me funksion social-ekonomik, të cilët duhet të kryejnë pagesën e parcelës ndërtimore të plotë sipas hartës së vlerës së pronës në zonën përkatëse.

-Për sa më sipër, ALUIZNI Berat duhej të kishte përlllogaritur dhe arkëtuar më shumë **396,668 lekë, vleftë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e ALUIZNI-t Berat** (trajtuar në faqet 94 deri 99 Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-Berat, të marrë masa duke ndjekur rrugët ligjore për llogaritjen dhe arkëtimin e vlerës në **7 raste në shumën 396,668 lekë**, prej të cilave dosja 297, subjekti informal K.R **52,396 lekë** (26,198 lekë dhe 26,198 bono privatizimi); dosja 42 E.A **97,155 lekë** (48,577 lekë dhe 48,578 bono privatizimi); Dosja nr. 359, V.Q **101,578 lekë** (50,789 lekë dhe 50789 bono privatizimi); Dosja nr. 83, R.B **116,050 lekë** (58,025 lekë dhe 58,025 bono); Dosja nr. 1215/5, N.H **8,320 lekë** (4,160 lekë dhe 4160 bono); Dosja nr. 879, Sh.R **6,400 lekë** (3,200 lekë dhe 3,200 bono); Dosja nr. 7, S.Xh **14,769 lekë** (7,384 lekë dhe 7,385 bono)

*Deri më datë 30.10.2016*

**3. Gjetje nga auditimi.** Nga analizimi i pasqyrave financiare (pasiv-aktivi), u konstatua se në zbatim të VKM nr. 50. datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të plan veprimi”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, nga Drejtoria e ALUIZN-t është bërë likuidimi i detyrimeve të prapambetura. Parë në këndvështrimin kohor të krijimit të detyrimeve, rezulton se në 15 raste janë bërë pagesa në favor të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat **për penaltete** për vonesat e pagesave për detyrimet tatimore mbi të ardhurat nga punësimi(TAP) në shumën 211,459 lekë dhe **gjoba** në shumën 133,651 lekë. Vlera në



shumën **345,110** lekë paguar për penaltete e gjoba përbën dëm ekonomik (*Trajtuar më hollësisht në faqen 100-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3. Rekomandimi:** Mbështetur në pjesën VI, kreu I, nenet 105-109, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, dhe udhëzimin e Ministrisë të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit dhe Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, me qëllim arkëtimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **345,110** lekë nga ish drejtori K.P.

*Afati: Deri më datë 30.09.2016*

**4. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurave të prokurimit u konstatua se në tenderin me objekt “Për kryerjen e shërbimit të evidentimit faktik në terren të ndërtimeve pa leje” me vlerë të fondit limit 8,000,000 lekë (pa tvsh) ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit. Në zhvillimin e tenderit kundrejt fondit dhe çmimit të përcaktuar nuk është caktuar sasia e kateve. Nga auditimi llogaritet se firma “K. shpk” duhet të shpallej fituese për 1000 kate me vlerë të ofertës më të ulët në vlerën 7,550,000 lekë. Nga e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave rezulton se është kualifikuar fituese firma “K1” me vlerën 8,000,000 lekë, për të cilën është lidhur kontrata nr. 4168 datë 03.11.2015, midis Drejtorisë së Aluizni-t Berat përfaqësuar nga Drejtori P.S dhe operatorit K sh.p.k. përfaqësuar nga nga Y.K, administrator i shoqërisë. Për rrjedhojë është shkaktuar mos përdorim me ekonomicitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, si dhe tejkalim i vlerës së kontratës në shumën **450,000** lekë, që përbën dëm ekonomik (*Trajtuar më hollësisht në faqen 113-121, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Berat, të marrë masa për ndërprerjen e pagesës në shumën **450.000** lekë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik të pa ekzekutuar nga buxheti i Drejtorisë ndaj operatorit ekonomik “ K. shpk, në kontratën e lidhur me shkresë nr. 4168, datë 03.11.2015, me objekt “Shërbimi i evidentimit faktik në terren të ndërtimeve pa leje”. Drejtoria e ALUIZNI-t Berat të bëjë rishikimin e kontratës për "Shërbimin i evidentimit faktik në terren të ndërtimeve pa leje” duke kërkuar realizimin e saj sipas fondit të ofertuar nga operatori ekonomik “K” shpk, për 1000 kate me fond **7,550,000** lekë pa tvsh.

*Menjëherë.*

**5.Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi i veprimeve të kryera me bankë, rezulton se në vitin 2015 në 3 raste, në shumën **462,900** lekë. është bërë pagesa për kthim vlere për objektet informate, të cilët për mosplotësim kriteresh s’kualifikohen ose është ndërprerë procesi i legalizimit të objektit. Ky veprim bie në kundërshtim me Vendim nr. 280, datë 01.04.2015 për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje.

-Nga auditimi i dosjes nr. 218, rezulton se është paguar qytetari I.B në shumën **117,000** lekë, pasi objekti është kualifikuar për legalizim sipas aktit nr. 397, datë 17.03.2009, firmosur nga ish përgjegjësi i legalizimit urbanizimit A.M dhe ish Drejtori K.P.

-Nga auditimi i dosjes nr. 176 së qytetarit N.L është bërë pagesa në shumën **210,000** lekë, pasi rezulton se objekti është kualifikuar për legalizim sipas aktit nr. 384, datë 21.08.2009.

Dokumenti rezulton i pa firmosur nga Përgjegjësi i sektorit të Hartografisë R.B, Përgjegjësi i sektorit të regjistrimit Fillestar D.C.

Nga auditimi i dosjes nr. 1784 të qytetarit Xh. Z është bërë pagesa në shumën **135,900** lekë, pasi rezulton se objekti është kualifikuar për legalizim sipas aktit pa numër, datë 21.08.2009. Akti nuk është firmosur nga Përgjegjësi i Sektorit të Hartografisë R.B, Përgjegjësi i Sektorit të Regjistrimit Fillestar D.C dhe Përgjegjësjë e Sektorit të Urbanistikës dhe Legalizimit A.G. Procesverbali datë 17.03.2009 i vlerësimit të dosjes, nuk është firmosur nga Sektori i Legalizimit me Përgjegjës A.M.

**Në dosjet e mësipërme nuk ka akt skualifikimi dhe shkaqet e skualifikimit** (*Trajtuar më hollësisht në faqen 101-112, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Berat, të marrë masa duke ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **462,900** lekë nga qytetarët I.B, N.L dhe Xh.Z, për zbatim të gabuar të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 3, datë 17/01/2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014”.

*Deri më datë 30.10.2016*

### **C. MASA DISIPLINORE:**

**C.1** Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kreun IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe nenet 11 dhe 12 të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t Tiranë**, që bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", me ndryshime dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara me **“Zgjidhjen e Kontratës së Punës”**, për **Z. P.S, Drejtor i ALUIZNI-t Berat**, pasi:

-Në **5 dosje legalizimi**, sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta digjitale e paraqitur, rezulton se objektet ndodhen në distanca prej buzës së Lumit “Osum” prej 90-170 metra dhe në këtë rast nuk duhet të jepej leja e legalizimit ose procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit, gjë që nuk ka ndodhur, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacion justifikues për këtë qëllim.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 111/2012, datë 15.12.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, neni 4, pika 8, neni 5 dhe neni 84 “Veprimtaritë në brigje”, për sa vijon:

- -Në 1 dosje largësia nga bregu është 5-100 m, në kundërshtim me nenin 84/a.
- -Në 4 dosje largësia nga brigjet është 100-200 m, në kundërshtim me nenin 84/b.

-VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, Kapitulli II, pika 2, germa “gj” dhe Kapitulli III, pika 4, germa “dh” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 40-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **3 dosje legalizimi**, u konstatua se sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP Berat, parcelat ndërtimore të zëna ndodhen në zonat përkatëse, të regjistruara në zërin kadastral

“Kullotë”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në “Truall”, në kundërshtim, me nenet 10 dhe 17/3, 6, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 46-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **17 dosje legalizimi**, legalizimet janë kryer bazuar në dokumentacionin e lëshuar nga ZVRPP Berat, ku situata juridike paraqitet për pronë “Të paregjistruar”. Konstatohet se sipas Hartës Treguese të Regjistrimit (HTR), bashkëlidhur shkresave të dërguara nga ZVRPP-ja, kemi të bëjmë me pasuri “Ndërtesë”, pronë “Shtet”, të cilat janë adaptuar, përderisa kanë shenjat konvencionale për të qenë të tilla, sipas Rregullores së Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar, ku ndërtimi rezulton “i ligjshëm”. Këto ndërtesa nuk duhej të ishin legalizuar për arsye se ndërtimi është në pronë shtet (*Trajtuar më hollësisht në faqet 48-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **20 dosje legalizimi**, në parcelat ndërtimore pronë “Shtet”, konstatohet se sipas dokumentacionit të pronësisë, dërguar me shkresat e ZVRPP- së Qarku Berat, statusi juridik për pasuritë është pronë “E paregjistruar”, nuk ka të dhëna të tjera dhe mungon Harta Treguese e Regjistrimit (HTR), në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **84 dosje legalizimi**, proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat e objektit nga pasuritë kufitare me shifra dhe fjalë, jo sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **26 dosje legalizimi**, proces-verbali i verifikimit në terren është mbajtur nga 1 person, jo sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, date 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **38 dosje legalizimi**, konstatohet mungesë e ortofotove digjitale, në mospajtim me shkronjën “b”, pika 3, kapitulli I, e VKM nr. 589, datë 10.09.2014 “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **4 dosje legalizimi**, konstatohet se nuk ishin plotësuar dhe nënshkruar 2 deklaratat personale në kundërshtim me nenin 27, pika “dh”, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **48 dosje legalizimi**, sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë, ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, Ullishte, Pemishte”, zona informale këto të pa miratuara nga KRRTRSH/KKT, pra legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, për të cilat nuk kanë gjetur zbatim nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Truall” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 84-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **9 dosje legalizimi**, u konstatua **dëm ekonomik 453,208 lekë**, si me poshtë:

-Në 7 raste për objekte me funksion social-ekonomik, pagesa e vlerës së parcelës ndërtimore, është kryer duke aplikuar favorizimet nëpërmjet çmimit favorizues të shitjes së parcelës, me justifikime të ndryshme të kundërligjshme. Për sa më sipër, ALUIZNI Berat duhej të kishte

përlllogaritur dhe paguar më shumë 396,668 lekë, *vleftë e cila përben dëm ekonomik për buxhetin e ALUIZNI-t Berat.*

-Në 2 raste për 56,540 lekë, nuk gjenden dokumentet për likuidimin e taksës së infrastrukturës dhe tarifave të shërbimit, në kundërshtim me pikën “ç” të nenit 27 dhe pikën “ë”, neni 24, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dokumente të cilët nuk ishin inventarizuar apo arkivuar në dosje dhe në protokollin e institucionit, mosveprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 94-98, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**C.2.** Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kreun IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe nenet 11 dhe 12 të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t Tiranë**, që bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", me ndryshime dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara nga “**Vërejtje**” deri në “**Zgjidhjen e Kontratës së Punës**”, për 3 **punonjësit** si më poshtë:

### **1. Znj. E.K, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit dhe Planifikimit Urban.**

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

-Në **5 dosje legalizimi**, sipas dokumentacionit disponibël në dosje, si genplani, harta dixhitale e paraqitur, rezulton se objektet ndodhen në distanca prej buzës së Lumit “Osum” prej 90-170 metra dhe në këtë rast nuk duhet të jepej leja e legalizimit ose procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit, gjë që nuk ka ndodhur, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacion justifikues për këtë qëllim,

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 111/2012, datë 15.12.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, neni 4, pika 8, neni 5 dhe neni 84 “Veprimtaritë në brigje”, për sa vijon:

-Në 1 dosje largësia nga bregu është 5-100 m, në kundërshtim me nenin 84/a.

-Në 4 dosje largësia nga brigjet është 100-200 m, në kundërshtim me nenin 84/b.

-VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, Kapitulli II, pika 2, germa “gj” dhe Kapitulli III, pika 4, germa “dh” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 40-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **3 dosje legalizimi**, konstatohet se nuk ishin plotësuar dhe nënshkruar 2 deklaratat personale në kundërshtim me nenin 27, pika “dh”, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar:

- për marrjen e përgjegjësisë lidhur me zbatimin e planit rregullues/studimit urbanistik pjesor, përfshirë këtu: respektimin e hapësirave publike, gjelbërimin, tipin e rrethimit, ngjyrat, ndriçimin, parkimin, etj.

-për marrjen e përgjegjësisë personale të mbartjes së kostos së dëmtimeve që vijnë si pasojë e cilësisë së punimeve të kryera në objekt dhe shkaqeve natyrore, kur nuk janë respektuar kushtet teknike (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

## **2.Znj. D. Ç, specialiste e hartografisë**

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

- Në **2 dosje legalizimi**, legalizimet janë kryer bazuar në dokumentacionin e lëshuar nga ZVRPP Berat, ku situata juridike paraqitet për pronë “Të paregjistruar”. Konstatohet se sipas Hartës Treguese të Regjistrimit (HTR), bashkëlidhur shkresave të dërguara nga ZVRPP-ja, kemi të bëjmë me pasuri “Ndërtesë”, pronë “Shtet”, të cilat janë adaptuar, përderisa kanë shenjat konvencionale për të qenë të tilla, sipas Rregullores së Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar, ku ndërtimi rezulton “i ligjshëm”. Këto ndërtesa nuk duhej të ishin legalizuar për arsye se ndërtimi është në pronë shtet, *(Trajtuar më hollësisht në faqet 48-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

- Në **12 dosje legalizimi**, sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë, ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, Ullishte, Pemishte”, zona informale këto të pa miratuara nga KRRTRSH/KKT, pra legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, për të cilat nuk kanë gjetur zbatim nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Truall” *(Trajtuar më hollësisht në faqet 84-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

## **3. Z. E.N, specialist vlerësues, jurist.**

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

-Në **5 dosje legalizimi** për objekte me funksion social-ekonomik, pagesa e vlerës së parcelës ndërtimore, është kryer duke aplikuar favorizimet nëpërmjet çmimit favorizues të shitjes së parcelës, me justifikime të ndryshme të kundërligjshme, në një kohë që VKM nr. 488, datë 22.07.2014, bën fjalë për lehtësitë e personave që legalizojnë objekte me funksione banimi dhe të përziera. Këtu përjashtohen objektet me funksion social-ekonomik, të cilët duhet të kryejnë pagesën e parcelës ndërtimore të plotë sipas hartës së vlerës së pronës në zonën përkatëse.

-Për sa më sipër, ALUIZNI Berat duhej të kishte llogaritur më shumë 344,272 lekë, *vleftë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e ALUIZNI-t Berat (Trajtuar më hollësisht në faqet 94 -99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

-Në **2 dosje legalizimi për 56,540 lekë**, nuk gjenden dokumentet për likuidimin e taksës së infrastrukturës dhe tarifave të shërbimit, në kundërshtim me pikën “ç” të nenit 27 dhe pikën “ë”, neni 24, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar *(Trajtuar më hollësisht në faqet 94 - 99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

## **“Vërejtje me shkrim”.**

### **1. Z. F.A, specialist i sektorit të hartografisë**

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

- Në **1 dosje legalizimi**, legalizimet janë kryer bazuar në dokumentacionin e lëshuar nga ZVRPP Berat, ku situata juridike paraqitet për pronë “Të paregjistruar”. Konstatohet se sipas Hartës Treguese të Regjistrimit (HTR), bashkëlidhur shkresave të dërguara nga ZVRPP-ja, kemi të bëjmë me pasuri “Ndërtesë”, pronë “Shtet”, të cilat janë adaptuar, përderisa kanë shenjat konvencionale për të qenë të tilla, sipas Rregullores së Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar, ku ndërtimi rezulton “i ligjshëm”. Këto ndërtesa nuk duhej të ishin legalizuar për arsye se ndërtimi është në pronë shtet (*Trajtuar më hollësisht në faqet 48-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **33 dosje legalizimi**, proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat e objektit nga pasuritë kufitare me shifra dhe fjalë, jo sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **2. Z. H.B, specialist i verifikimit në terren**

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

- Në **27 dosje legalizimi**, proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat e objektit nga pasuritë kufitare me shifra dhe fjalë, jo sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **3.Znj. A.G, specialist i sektorit të hartografisë**

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

- Në **21 dosje legalizimi**, proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat e objektit nga pasuritë kufitare me shifra dhe fjalë, jo sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **4. Z. E.M, specialist i verifikimit në terren**

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

- Në **12 dosje legalizimi**, proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat e objektit nga pasuritë kufitare me shifra dhe fjalë, jo sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### 5. Z. B.P, specialist i verifikimit në terren

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

- Në **21 dosje legalizimi**, proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat e objektit nga pasuritë kufitare me shifra dhe fjalë, jo sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t (Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### 6. Z. F.T, specialist i verifikimit në terren

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

- Në **14 dosje legalizimi**, proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat e objektit nga pasuritë kufitare me shifra dhe fjalë, jo sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t (Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### 7. V.B, me detyrë përgjegjëse e sektorit të financës.

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

-Vonesat e pagesave për detyrimet Tatimore mbi të ardhurat nga punësimi si dhe gjoba e penalitete në vlerën **345,110** lekë paguar për penalitete e gjoba përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin e buxhetit të shtetit nr. 9936, datë 26.06.2008 i ndryshuar, me nenin 40 “**E drejta për të kryer shpenzime**” Fondet e miratuara në vendimin për buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore përbëjnë kufirin maksimal të shpenzimeve, brenda të cilit kryetari i njësisë së qeverisjes vendore është i autorizuar të marrë përsipër angazhime dhe të kryejë shpenzime, nenin 52 “**Kryerja e shpenzimeve**” ku citohet se procesi dhe përgjegjësitë për autorizimin dhe kryerjen e shpenzimeve publike përcaktohen në ligjin për kontrollin e brendshëm financiar publik. Shpenzimet e njësisë të qeverisjes së përgjithshme verifikohen në bazë të dokumentacionit të plotë, që vërteton kryerjen e shpenzimit përkatës, sipas ligjit për kontrollin e brendshëm financiar publik. Kryerja e shpenzimeve bëhet vetëm nëse masa e shpenzimit nuk kalon fondet e angazhuara për këtë qëllim. Shpenzimet, që rezultojnë nga angazhime të marra përsipër gjatë viteve të mëparshme, në përputhje me dispozitat e veçanta të ligjit të buxhetit vjetor, përfshihen në buxhetin e vitit pasardhës. Shpenzimet e fondeve të miratuara të Buxhetit të Shtetit dhe të buxhetit vendor realizohen deri në fund të vitit buxhetor. Shlyerja e angazhimeve, me përfundimin e afatit të parashikuar në paragrafin më lart, realizohet me fondet e miratuara për vitin buxhetor pasardhës, me përjashtim të rasteve kur shpenzimi është kryer përpara mbarimit të vitit buxhetor. Në këtë rast, pagesa kryhet brenda datës 31 janar të vitit buxhetor pasardhës. Kjo periudhë shërben për përgatitjen e dokumentacionit bazë dhe për kryerjen e pagesës.

**8.E.N**, jurist në cilësinë e anëtarit të Njësisë Prokurimit;

**9.E.M**, inxhinier ndërtimi, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit;

### Sepse:

-Hartimi i kërkesës për përcaktimin e nevojave për prokurim është bërë pa përllogaritur nevojat në mënyrë të qartë e të saktë, duke mos identifikuar dosjet më të plota nga ana dokumentare dhe më të sakta nga ana juridike, që mundësojnë qëllimin e akordimit të fondit për përshejtimin e procesit të legalizimit sipas zonave informale të shtrira dhe të klasifikuara në zona kadastrave (ZK), që do të mbulohen me këtë shërbim, veprime në kundërshtim me pikat 1 dhe 2 e nenit 12, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Kreu II “Organizimi i prokurimit publik”.

-Në hartimin e specifikimeve teknike dhe licencave, nuk është bërë përcaktimi i mjeteve apo pajisjet teknike të punës, programet specifike të fushës dhe certifikimet për to, që duhet të disponohen nga ofertuesit për kryerjen e këtij shërbimi, veprime në kundërshtim me nenin 28, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Përllogaritja e vlerës limit të kontratës është barasvlerësuar me fondin në dispozicion dhe jo sipas përcaktimit të çmimit duke ju referuar tarifës së shërbimit prej 8,000 lekë/kat për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik dhe objektet e dyta, të miratuar me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, *pra vlera e fondit limit nuk është përllogaritur në bazë nevojash (sasia) dhe çmimit*, veprime këto në kundërshtim nenet 9, 57, 59, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Nuk përcaktohen tarifat për rastet për objektet për banim, si dhe për rastet e shërbimit për përditësim, pra nuk ka diferencim të tarifave të shërbimit që do të kryhen sipas kateve të llojeve të objekteve.

-Nuk është përcaktuar çmim i analizuar në bazë të termave të referencave, sipas zërave të këtij shërbimi, por thjesht i janë referuar kësaj tarife, për të cilën nuk ka asnjë të dhënë për analizën e kostos mbi të cilën është përcaktuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 11 nën-pika 3/c, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” .

-Në Dokumentet Standarte të Tenderit (DST), në shtojcën 1-*Formulari Ofertës*, tek kolona “Përshkrimi i Shërbimeve” është përcaktuar vetëm 1 shërbim në total me emërtimin “Shërbimi i evidentimit në terren dhe hartimit të dokumentacionit sipas gjendjes faktike të ndërtimeve pa leje për 1 kat (njësi)”, pa përcaktuar zërat përbërës të këtij shërbimi të përcaktuar në Shtojcën 11 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit” dhe specifikimet teknike në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 17 “Oferta ekonomike”. Gjithashtu në ofertë është cilësuar në mënyrë të gabuar “çmimi më i ulët për kat” dhe jo “vlera më e ulët e fondit” të llogaritur.

- Është përcaktuar “Marrëveshje kuadër”, në kundërshtim me nenin 45 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, pasi në rastin konkret kemi të bëjmë me një prokurim, ku çmimet e tregut nuk kanë ndryshime për një kohe të gjatë dhe nuk kanë periudha piku. Ky rast nuk dikton nevojën e marrëveshjes kuadër.

### **C.3. Për punonjësit e larguar nga detyra dhe që nuk kanë adresim institucional:**

**Për ish-drejtnes dhe specialistë**, nuk mund të rekomandohet masë disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre, **të merren masa dhe të njoftohet Departamenti i Administratës Publike**, për masën disiplinore mbi bazën e shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për 3 **ish-punonjës**, si më poshtë:



### ***L.E.S, ish- Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë***

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

- Në **3 dosje legalizimi**, u konstatua se sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP Berat, parcelat ndërtimore të zëna ndodhen në zonat e regjistruara në zërin kadastral “Kullotë”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në “Truall”, në kundërshtim, me nenet 10 dhe 17/3, 6, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 46-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **84 dosje legalizimi**, proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat e objektit nga pasuritë kufitare me shifra dhe fjalë, jo sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **26 dosje legalizimi**, proces-verbali i verifikimit në terren është mbajtur nga një person dhe jo sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, date 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **38 dosje legalizimi**, konstatohet mungesë e ortofotove digjitale, në mospajtim me shkronjën “b”, pika 3, kapitulli I, e VKM nr. 589, datë 10.09.2014 “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **36 dosje legalizimi**, sipas dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, Ullishte, Pemishte”, zona informale këto të pa miratuara nga KRRTRSH/KKT, pra legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, për të cilat nuk kanë gjetur zbatim nenet 10, 11 dhe 14 të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.5.2009 e VKM nr. 589, datë 10.9.2014, “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrove të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Truall” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Në **20 dosje legalizimi**, në parcelat ndërtimore pronë “Shtet” konstatohet se sipas dokumentacionit të pronësisë, dërguar me shkresat e ZVRPP- së Qarku Berat, statusi juridik për pasuritë është pronë “E paregjistruar”, nuk ka të dhëna të tjera dhe mungon Harta Treguese e Regjistrimit (HTR), në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **14 dosje legalizimi**, legalizimet janë kryer bazuar në dokumentacionin e lëshuar nga ZVRPP Berat, ku situata juridike paraqitet për pronë “Të paregjistruar”. Konstatohet se sipas Hartës Treguese të Regjistrimit (HTR), bashkëlidhur shkresave të dërguara nga ZVRPP-ja, kemi të bëjmë me pasuri “Ndërtesë”, pronë “Shtet”, të cilat janë adaptuar, përderisa kanë shenjat konvencionale për të qenë të tilla, sipas Rregullores së Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar, ku ndërtimi rezulton “i ligjshëm”. Këto ndërtesa nuk duhej të ishin legalizuar për arsye se ndërtimi është në pronë shtet (*Trajtuar më hollësisht në faqet 84 - 94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **2.O.B, ish- specialist i verifikimit në terren**

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

- **Në 9 dosje legalizimi**, proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat e objektit nga pasuritë kufitare me shifra dhe fjalë, jo sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t (Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **3.J.D, ish- specialist i verifikimit në terren**

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

- **Në 8 dosje legalizimi**, proces-verbali i verifikimit në terren nuk është plotësuar me distancat e objektit nga pasuritë kufitare me shifra dhe fjalë, jo sipas formularit të aprovuar me urdhrat nr. 766, datë 10.09.2014 dhe nr. 851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t (Trajtuar më hollësisht në faqet 55-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Administrimit Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**